

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 8167 Kol
Nr. 1367 Rep



KONTRATË
PËR SHIT-BLERJE KUOTASH

Sot, më datë 31.10. 2001 para meje A. Robo, Noter i Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqitën personalisht shtetasit shqiptar, Sokol Hoxha dhe Artur Dushku, me cilësinë e shitësit dhe shtetasi shqiptar Irfan Hysenbelliu, me cilësinë e blerësit, të cilët më kërkuan redaktimin e kësaj Kontrate për Shit-Blerjen e një pjese të kuotave të kapitalit themeltar me termat e mëposhtëm :

SHITËS : Sokol Hoxha i datëlindjes 14.02.1951, lindur në Tiranë dhe banues në adresën: Rruga "Brigata e VIII", Pall.8, Ap.6, Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr.EV 219111.

Artur Dushku i datëlindjes 31.05.1955, lindur në Tiranë dhe banues në adresën: Rruga "Labinoti", Pall 8, SH.3, Ap.35, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr.0026421.

BLERËS : Irfan Hysenbelliu i datëlindjes 08.04.1959, lindur në Skrapar, banues në Tiranë në adresën: Rruga "Pjetër Bogdani", Pall.11, Ap.6, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr.299990.

OBJEKTI : Shitja e kapitalit themeltar të shoqërisë tregtare "ALCO-SYSTEM" sh.p.k. në masën 30%.

PËRMBAJTJA E KONTRATES

Shoqëria tregtare "ALCO-SYSTEM" sh.p.k është regjistruar në Rregjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë me vendimin nr.21585, date 02.07.1999 .

Shoqëria është themeluar me një kapital themeltar prej 100.000 lekë dhe me ortakë themelues shtetasit shqiptar Irfan Hysenbelliu, Sokol Hoxha dhe Artur Dushku.

Shitja e pjesës të shitësve prej 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë tregtare "ALCO-SYSTEM" sh.p.k., është e përbërë nga humbja e së drejtës së pronësisë së dy ortakëve mbi kuotat e secilit në masën 15%, si pasojë e miratimit të këtij transaksioni shitjeje, shprehur kjo në vendimin e asamblesë së ortakëve datë 26.10.2001.

Shitësit, Sokol Hoxha dhe Artur Dushku, janë plotësisht dakort dhe i shesin me vullnetin e tyre të plotë Blerësit, pjesën prej 30% të kuotave nga pjesët e tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë tregtare "ALCO-SYSTEM" sh.p.k.

MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate Shitësit Sokol Hoxha dhe Artur Dushku, e humbasin pronësinë e tyre në masën 15% të kuotave secili, në kapitalin themeltar të shoqërisë, ndërsa Blerësi Irfan Hysenbelliu bëhet zotëruar i kësaj pjese duke zëvendësuar me të gjitha të drejtat dhe detyrimet ortakët e larguar nga shoqëri.

Shoqëria tregtare "ALCO-SYSTEM" sh.p.k., pas realizimit të kësaj kontrate shit-blerje do të ketë si ortak të vetëm të saj z.Irfan Hysenbelliu me pjesmarrje 100% të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë.

ÇMIMI I SHITJES SË KUOTAVE

Si çmim i këtij transaksioni të shit-blerjes së kuotave të shoqërisë "ALCO-SYSTEM" sh.p.k. do të jetë ai i vlerës nominale të një kuote. Vlera nominale e një aksioni është e barabartë me 1.000 lekë.

Sipas këtij përcaktimi blerësi paguan në favor të shitësve 30.000 lekë, të cilat do të ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet tyre, shumë e cila është paguar jashtë kësaj zyre.



DISPOZITA TË FUNDIT

Kontrata hartohet në pesë kopje të njëjta, një depozitohet në Zyrën e Rregjistrimit Tregtar, një kopje depozitohet në Aktet e Shoqërië, një kopje pranë Zyrës së Noterisë ku ajo u redaktua dhe nga një kopje e mbajnë palët.

Termat e kontratës pasi u redaktuan prej meje Noterit iu bënë të njohura palëve kontraktuese, të cilat e nënshkruan atë me vullnetin e lirë dhe të plotë, në prezencën time.

PALËT

SHITËS

Sokol HOXHA

Artur DUSHKU

Artur Dushku

Artur

Sokol Hoxha

BLERËS

Ifran HYSENBELLIU

Ifran Hysenbelliu

2001

NOTER



Robo

[Signature]

